



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2020:037751  
Datë: 27.05.2024  
Numri i dokumentit: 05739408

**E.nr.827/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në lëndën përmbartimore të kreditorit F.B. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, për pagesën e shpërblimit jubilar dhe shpenzimet e procedurës, më datë 27.05.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.827/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditores.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.827/23, të datës 22.05.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditores, kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, për pagesën e shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.542/2020, të datës 13.10.2020.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 06.10.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,765.92 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditores.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.827/23, më datë 27.05.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**